

**VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT FILLOR**



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË

**QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE**

**VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT FILLOR**

**Për të gjithë nxënësit dhe mësuesit e  
Arsimit Fillor**

**Mars 2020**

**VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT FILLOR**

**QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE**

**VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT FILLOR**

**Për të gjithë nxënësit dhe mësuesit e Arsimit Fillor**

Qendra e Shërbimeve Arsimore u krijua për të ndikuar në procesin e të nxënësve në shkollë përmes vlerësimit. Me qëllim që ta përmbushë këtë mision të saj, ajo është përpjekur maksimalisht të sigurojë se të gjitha vlerësimet që ajo ndërmerr, të jenë të drejta, etike dhe në përputhje me standardet teknike.

Ne jemi të ndërgjegjshëm mbi shkallën në të cilën vlerësimi ndikon në modelet dhe përmbajtjen e të nxënësve në klasë. E gjithë puna jonë, në koherencë me kurrikulën, thekson rëndësinë e përputhjes mes qëllimeve, pedagogjisë, materialeve të të nxënësve dhe vlerësimit.

Ky material është hartuar të kontribuojë në këtë proces koherence.

---

Qendra e Shërbimeve Arsimore ofron një metodë drejt një cilësie më të lartë, drejt një lidhjeje më të mirë midis të nxënësve dhe vlerësimit, duke nxitur përmirësimin e procesit të të nxënësve në klasë.

---

**Si ta lexojmë këtë material**

**Për ta bërë sa më të lehtë përdorimin e këtij materiali, përmbajtjen e tij e kemi ndarë në dy seksione.**

**Seksioni 1 përmban testet e përdorura në VANAF, bashkë me një informacion mbi përmbajtjet e testeve, kompetencat që vlerësohen, pesha që zë çdo kompetencë, llojet e pyetjeve etj.**

**Seksioni 2 përmban skemat e vlerësimit për testet e përdorura në VANAF.**

**Pasqyra e lëndës**

**Hyrje .....6**

**SEKSIONI 1**

**Testimi dhe modele testesh të VANAF..... 8**

**SEKSIONI 2**

**Skema të vlerësimit të testeve të VANAF.....62**

### HYRJE

Matja e arritjeve të nxënësve, në përfundim të një niveli arsimor, shërben jo vetëm për të pasqyruar funksionimin e sistemit arsimor në kontekstin e politikave arsimore aktuale, por edhe për të ndërtuar politika të reja arsimore. Rezultatet e nxënësve përfaqësojnë treguesin kryesor të cilësisë dhe të performancës së sistemit arsimor, sidomos kur kjo lidhet me synimin për pajisjen e nxënësve me njohuri dhe me kompetenca për përballimin e kërkesave të kohës.

Prindërit, nxënësit, mësuesit, drejtuesit e shkollave, politikëbërësit dhe publiku i gjerë kanë nevojë që të kenë informacionin e duhur lidhur mbi performancën e sistemit arsimor dhe sa mirë ky sistem i përgatit nxënësit për t'u përballur me jetën. Rezultatet e Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve të Arsimit Fillor, si një vlerësim i jashtëm i standardizuar japin të dhënat e nevojshme për të monitoruar performancën e sistemit arsimor dhe nivelin e arritjeve të nxënësve.

Ky material përmban testet e Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve të Arsimit Fillor, të shoqëruara bashkë me skemat e vlerësimit.

Ky material u shërben mësuesve, specialistëve të arsimit, nxënësve dhe të gjithë të interesuarve në funksion të përmirësimit në arritjet e standardeve të mësimdhënies dhe të nxënësve në shkollë.

### Çfarë është Vlerësimi i Arritjeve të Nxënësve të Arsimit Fillor

Testi i përdorur për vlerësimin e arritjeve ishte një test i integruar, i cili përfshin pyetje nga tri fusha: Gjuha shqipe, Matematika dhe Dituria e natyrës.

Ky vlerësim i integruar mat njohuritë dhe kompetencat e tyre në tri fusha:

- Gjuhë shqipe
- Matematikë
- Dituri Natyre

Ky vlerësim synon gjithashtu dhënien e informacionit për prindërit, mësuesit, si dhe të gjitha institucionet e arsimit në vend në lidhje me arritjet e nxënësve në kompetenca të caktuara të secilës fushë.

### Cili është qëllimi i këtij publikimi?

Përmes këtij publikimi, ku përmbledhen disa teste të VANAF, synojmë t'u japim nxënësve, prindërve, mësuesve dhe të interesuarve të tjerë një mundësi që të familjarizohen me përmbajtjen e testit dhe llojet e pyetjeve që përdoren në të. Kur nxënësit e dinë se çfarë duhet të bëjnë në një test të VANAF, ata përgatiten edhe më mirë në një situatë më praktike, ku përfshihen të gjitha hapat që ka një test i tillë i standardizuar.

### PËR NXËNËSIT

Nxënësit mund t'i përdorin këto modele:

- për t'u familjarizuar me llojet e pyetjeve;
- për të mësuar se si t'i japin përgjigjet e tyre.

Duke parë këto modele disa kohë përpara testimit, nxënësit do të kuptojnë se çfarë do t'iu kërkohet të bëjnë. Si rezultat, ata do të jenë në gjendje të fokusohen në demonstrimin e aftësive të tyre në secilën nga fushat në ditën e testimit.

## PËR PRINDËRIT

Prindërit mund t'i përdorin këto modele:

- për të kuptuar kompetencat që nxënësit duhet të demonstrojnë në testin e VANAF;
- për të kuptuar llojin e pyetjeve për të cilat fëmijët e tyre do të përgjigjen në test për të demonstruar se i zotërojnë këto kompetenca.

## PËR MËSUESIT

Mësuesit mund t'i përdorin këto modele:

- për të kuptuar llojin e pyetjeve që përdoren në testin kombëtar të VANAF;
- për të kuptuar se si lidhen pyetjet me kompetencat që nxënësit duhet të zotërojnë në përfundim të arsimit fillor dhe që janë përshkruar në dokumentin zyrtar të kurrikulës së Arsimit Fillor.
- për t'i ndihmuar nxënësit të familjarizohen me kërkesat e testit;
- për të krijuar modele të ngjashme në klasë në ndihmë të nxënësve.

## **SEKSIONI 1**



## TESTIMI DHE MODELE TESTESH NË VLERËSIMIN E ARRITJEVE TË NXËNËSVE NË ARSIMIN FILLOR

Hartimi i testit të VANAF bazohet në një metodologji të mirëpërcaktuar. Natyrisht një test i tillë nuk mund të vlerësojë të gjitha njohuritë dhe kompetencat që nxënësi ka përfutur gjatë të gjitha viteve të shkollimit në Arsimin Fillor. Specialistët që hartojnë testin, kanë për detyrë të fokusohen në një përmbajtje të caktuar të lëndës, e cila specifikohet përmes programit orientues të VANAF të hartuar nga ASCAP (Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar).

Në mënyrë të përmbledhur çdo test i VANAF ka disa specifikime, ku bëjnë pjesë:

- përmbajtja: njohuri, shprehi, kompetenca,
- formati i testit (llojet e pyetjeve),
- totali i pyetjeve në test,
- totali i pikëve në test,
- koha (e testit dhe koha për secilin seksion),
- pikëzimi i pyetjeve,
- skemën e vlerësimit.

### Objektivat e Vlerësimit

Vlerësimi kombëtar i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të të arsimit të detyruar synon të vlerësojë njohuritë dhe kompetencat bazë, të fituara nga nxënësit në ciklin fillor, në lëndët Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Dituri natyre, në përfundim të vitit shkollor 2018-2019. Njëkohësisht, ky vlerësim kombëtar synon të vlerësojë aftësitë e nxënësve për të mbajtur qëndrime aktive ndaj njohurive dhe përvojës së fituar në shkollë, si dhe për të parë nevojat për ndërhyrje apo përmirësime të mëtejshme të komponentëve bazë të procesit mësimor.

## Gjuhë Shqipe

### Kompetencat në Gjuhën Shqipe

Objektivat kryesorë të vlerësimit në testin e Gjuhës shqipe kanë të bëjnë me vlerësimin e kompetencave të mëposhtme:

#### *A. Të lexuarit:*

##### *Nxënësi:*

- identifikon informacionet në një tekst;
- zbulon shkaqe dhe pasoja lidhur me veprimet e personazheve në tekst;
- nxjerr përfundime mbi arsyet e veprimeve të caktuara të personazheve në tekst;
- identifikon kuptime të fjalëve nisur nga situatat tekstuale;
- nxjerr përfundime mbi mesazhin e pjesës që lexon;
- bën interpretime personale mbi situata të caktuara të tekstit;
- shpjegon temën e pjesës dhe momente të caktuara të subjektit;
- dallon llojin letrar të tekstit.

#### *B. Të shkruarit:*

##### *Nxënësi:*

- planifikon një shkrim personal në përputhje me temën e esesë;
- organizon strukturën e tekstit, sipas llojit rrëfyes;
- zhvillon imagjinatën, duke nxjerrë përfundime të tjera nisur nga përfundimi i ngjarjeve të paraqitura në tekstin e dhënë;
- shkruan, duke prezantuar origjinalitet dhe stil vetjak në punën me shkrim;
- zbaton rregullat e drejtshkrimit dhe pikësimit përgjatë një punimi personal.

#### *C. Njohuri gjuhësore:*

##### *Nxënësi:*

- gjen sinonimet e fjalëve të caktuara në tekst;
- dallon gjuhën formale nga ajo joformale në një tekst;
- zbulon kuptimet e fjalëve në fjali;
- analizon fjalën nga pikëpamja e fjalëformimit;
- ndërton shumësin e grupeve emërore;
- dallon mbiemrat në fjali;
- përcakton vetën dhe kohën e foljes në një fjali;
- formon fjali më përemra të pacaktuar;
- përshtat foljen me kryefjalën në fjali të caktuara;
- zgjeron fjalitë me gjymtyrë të dyta, duke iu përshtatur kërkesave për kategoritë gramatikore të fjalëve me të cilat shprehen ato;
- shkruan fjali, duke iu përmbajtur kërkesës për atë se çfarë duhet të kumtojnë fjalitë;
- përdor drejt thonjëzat, si dhe të gjitha shenjat e pikësimit dhe drejtshkrimit.

**VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT FILLOR**

**Tabela e** specifikimeve sipas strukturës së testit, ilustron linjat dhe nënlinjat, si dhe përqindjet që i takojnë çdo linje. Ndarja është bërë për qartësimin e aftësive që zotëron nxënësi, dhe vlerësimin e tyre. Njëkohësisht, është mbajtur parasysh se linjat janë mësuar të integruara me njëra-tjetrën dhe, shpesh, janë parë të tilla edhe në kërkesat e testit.

*Tabela e specifikimeve për Gjuhën shqipe*

<b>Nr.</b>	<b>Linjat</b>	<b>%</b>	<b>Nr. i pikëve</b>	<b>Niveli i parë 30%</b>	<b>Niveli i dytë 40%</b>	<b>Niveli i tretë 30%</b>
<b>1</b>	Të lexuarit	45%	14	4	6	4
<b>2</b>	Të shkruarit	15%	4	1	2	1
<b>3</b>	Njohuritë gjuhësore	40%	12	4	5	3
	<b>TOTALI</b>	<b>100%</b>	<b>30</b>	<b>9</b>	<b>13</b>	<b>8</b>

## Matematikë

Hartimi i testit të Matematikës nuk vlerëson të gjitha njohuritë dhe kompetencat që nxënësi ka asimiluar gjatë viteve. Hartimi i testit, bazohet në programin orientues, të hartuar nga ASCAP (Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar). Në mënyrë të përmbledhur çdo test kombëtar ka disa specifikime, ku bëjnë pjesë:

- përmbajtja: njohuri, kompetenca,
- formati i testit (llojet e pyetjeve),
- totali i pyetjeve në test,
- totali i pikëve në test,
- nivelet e vështirësisë së testit dhe pyetjet për secilin nivel

### Kompetencat në Matematikë

Të gjitha kompetencat lëndore, mbi të cilat bazohet përmbajtja e testit, hartohen nga ASCAP. Bazuar në këto kompetenca, QSHA përgatit *objektivat e vlerësimit* (të specifikuara më poshtë), të cilat lidhen me rezultatet e arritjeve të të nxënësit. Vlerësimi i arritjeve për klasat e pesta zhvillohet me shkrim, dhe kompetencat *matematike* që do të vlerësohen janë:

- **Lidhja konceptuale dhe të menduarit matematik**, që nënkupton se nxënësi rikujton faktet me saktësi dhe përdor saktë terminologjinë, përkufizimet matematikore.
- **Zgjidhja e situatës problemore**, lidhet me modelimin e një situatë problemore, zbaton hapat për zgjidhjen e situatës problemore dhe interpreton zgjidhjen e situatës problemore.
- **Arsyetimi dhe vërtetimi matematik**, lidhet me identifikimin e elementeve të situatës matematikore, arsyetimin e përdorimit të koncepteve matematikore në situatën e dhënë.
- **Modelimi matematik lidhet me** gjetjen e zgjidhjes matematike, përkthimin e zgjidhjes matematike në zgjidhje të situatës në jetën reale.

### Përshkrim i përgjithshëm i testit të Matematikës

Testi i Matematikës për klasën e 5- të mbështetet në standardet e kurrikulës së këtij arsimi. Ai kontrollon ecurinë e nxënësve kundrejt kompetencave në matematikë.

### Lloji i pyetjeve në test

Në testin e matematikës përdoren pyetje të tipeve të ndryshme:

- ✓ pyetje me alternativa;
- ✓ pyetje me plotësim;
- ✓ pyetje me çiftim;
- ✓ pyetje me plotësimin e vendeve bosh me informacionin e duhur nga një përkufizim;
- ✓ pyetje me përgjigje të shkurtër ose me plotësim;
- ✓ pyetje që vlerësojnë vlefshmërinë e zgjidhjes së një situatë problemore.

## Rezultatet e të nxënit sipas tematikave në testin e matematikës

Rezultatet e të nxënit në testin e matematikës kanë të bëjnë me vlerësimin e kompetencave dhe rezultatet e të nxënit të ndara sipas tematikave të mëposhtme:

### • *Numri*

- kupton vlerën e secilës shifër në numrat pesë gjashtëshifrorë dhe i ndan në mijëshe, qindëshe, dhjetëshe dhe njëshe;
- rendit dhe krahason numra pozitivë dhe negativë në një bosht numerik ose në shkallën e termometrit;
- mbledh dy numra tre-katërshifrorë;
- pjesëton numrat dyshifrorë me numër dyshifrorë;
- zgjidh situata problemore duke përdorur veprimet dhe algoritmin e tyre;
- rendit thyesat nga më e vogla deri tek më e madhja;
- kupton dhe shkruan vlerën e secilës shifër në numrat gjashtëshifrorë.

### • *Matja*

- llogarit intervale të thjeshta në orë, dhe minuta;
- përdor formulën për syprinën e drejtkëndëshit.

### • *Gjeometri*

- zbaton vetitë për shumën e këndeve të trekëndëshit dhe kryen veprimet për të gjetur masën e këndit që mungon;
- identifikon koordinatat në rrjetën koordinative.

### • *Algjebër*

- gjen numrin që duhet vendosur në kutizë në barazime me mbledhje dhe me shumëzim;
- gjen numrin që duhet për të vërtetuar inekuacionin me jo më shumë se dy veprime.

### • *Statistika dhe probabiliteti*

- i përgjigjet një pyetjeje nga jeta e përditshme duke grumbulluar, zbuluar ose klasifikuar të dhënat për zgjidhjen e një situatë problemore.

Tabela e mëposhtme tregon mënyrën e shpërndarjes së pikëve të testit mbi bazën e përqindjes së tematikave në programin lëndor, si edhe mbi bazën e përqindjes së vështirësisë së kërkesave të testit.

VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT FILLOR

Blu printi i testit - (tabela e specifikimeve)

Nr.	Linja	% e linjës	Nr. i pikëve	Shkalla e vështirësisë		
				N.I. 30%	N.II. 40%	N. III. 30%
1.	Numri	57	10	3	4	3
2.	Matja	19	4	1	2	1
3	Gjeometri	15	3	1	1	1
4.	Algjebra dhe funksioni	2	1		1	
5	Statistika dhe probabiliteti	7	2	1		1
	<b>TOTALI</b>	<b>100</b>	<b>20</b>	<b>6</b>	<b>8</b>	<b>6</b>

Modelet e testeve janë një informacion shumë i mirë për mënyrën se si të përgatiteni për testim.

## Dituri Natyre

Testi për vlerësimin e arritjeve të nxënësve për arsimin fillor, bazohet në programin orientues të miratuar nga MASR, në të cilin gjuha shqipe dhe matematika, zënë një peshë më të madhe sesa dituria e natyrës. Për këtë arsye, pjesa e diturisë së natyrës përfaqësohet në test me më pak pikë, krahasuar me dy lëndët e tjera. Kështu, pyetjet e diturisë së natyrës zënë një total prej 10 pikësh.

Pavarësisht se në këtë material do të paraqiten modelet e testeve të viteve të kaluara, po ju japim një panoramë të përmbajtjes së testit për vitin shkollor 2019-2020, pasi testi i diturisë së natyrës për këtë vit shkollor është ndërtuar mbi kurrikulën e re, me bazë kompetencat.

Bazuar te programi orientues i VANAF, në pjesën e testit të diturisë së natyrës, nxënësit testohen për të matur dhe vlerësuar këto kompetenca (Programi orientues për provimin kombëtar të arsimit fillor, IZHA 2019):

⇒ Identifikimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre.

Kjo kompetencë matet nëpërmjet disa rezultateve të të nxënit:

Nxënësi:

- identifikon një problem ose përcakton një grup problemesh;
- përdor strategji të ndryshme eksplorimi;
- vlerëson qasjen e vet dhe të tjerëve.

⇒ Përdorimi i mjeteve, objekteve dhe procedurave shkencore.

Kjo kompetencë matet nëpërmjet disa rezultateve të të nxënit:

Nxënësi:

Kjo kompetencë matet nëpërmjet disa rezultateve të të nxënit:

- familjarizohet me rolet dhe funksionet e mjeteve, teknikave, instrumenteve dhe procedurave shkencore dhe teknologjike;
- përdor mjete, objekte dhe procedura të ndryshme në përputhje me situatat dhe mënyrat e përdorimit të tyre në to;
- vlerëson ndikimin e mjeteve, instrumenteve dhe procedurave.

⇒ Komunikimi në gjuhën dhe në terminologjinë e shkencës.

Kjo kompetencë matet nëpërmjet disa rezultateve të të nxënit:

Nxënësi:

- familjarizohet me gjuhën e jetës së përditshme që lidhet me shkencën dhe teknologjinë;
- përdor gjuhën e simboleve dhe të jetës së përditshme për shkencën dhe teknologjinë;
- përdor efektivisht gjuhën e simboleve dhe të jetës së përditshme për të formuluar pyetje dhe për të argumentuar përgjigjet.

Testi i diturisë së natyrës për vitin shkollor 2019-2020 është hartuar sipas tabelës së mëposhtme të specifikimeve, bazuar te pesha që zë secila nga tematikat në programin orientues.

## Tabela e specifikimeve të testit

Nr.	Tematika	Përqindja	Pikët për çdo tematikë	Nivelet		
				Niveli I 40%	Niveli II 40%	Niveli III 20%
1	Diversiteti	12	1	1		
2	Ndërveprimet	13	1		1	
3	Sistemet	38	4	2	1	1
4	Ciklet	13	2		1	1
5	Energjia	24	2	1	1	
<b>TOTALI</b>		<b>100</b>	<b>10</b>	<b>4</b>	<b>4</b>	<b>2</b>

Tabela e specifikimeve paraqet shpërndarjen e pikëve në test sipas peshës që zë çdo tematikë në programin orientues dhe sipas nivelit të vështirësisë së testit.

Pra, për të përgatitur nxënësit për provimin e VANAF, mësuesit duhet të bazohen në rezultatet e të nxënësve për secilën nga tematikat e paraqitura në programin orientues. Rezultatet e të nxënësve të përzgjedhura për t'u testuar janë kryesisht nga klasa e katërt dhe e pestë, madje peshën më të madhe e zë klasa e pestë.

### Llojet e pyetjeve në test

Duke qenë se dituria e natyrës zë një peshë të vogël në testin e integruar, përgjithësisht janë përdorur pyetje me alternativa ose pyetje me përgjigje të shkurtër, për të testuar sa më shumë njohuri dhe aftësi të nxënësve në këtë fushë.

Gjithashtu, llojet e pyetjeve të përdorura në test janë hartuar në mënyrë të tillë që të testojnë kryesisht aftësitë e nxënësve më shumë sesa njohuritë. Ato përmbajnë figura, tabela, ku nxënësit duhet të vëzhgojnë me vëmendje të dhënat e tyre për t'u përgjigjur pyetjeve.



**MODELI I**

**VANAF**

**Gjuhë shqipe**

***Elefanti dhe krokodili***

Një herë, një elefant dhe një krokodil po rrinin pranë lumit dhe bisedonin se cila ishte kafsha më e mirë.

- Shiko sa i fortë jam, - tha elefanti. - Me hundën time mund të shkul një pemë me gjithë rrënjë.
- Ah, por sasia nuk është cilësi. Lëkura jote nuk është aq e fortë sa e imja, - u përgjigj krokodili. - As shtiza, as shigjeta dhe as shpata nuk mund ta shpojë atë.

Në kohën që po bëheshin gati për t'u ndeshur, aty pranë kaloi një luan.

- Përshëndetje! - tha ai ndërsa po afrohej. - Pse po ziheni?
- A mund të na tregosh se cila është kafsha më e mirë? - thanë të dy njëherazi.
- Sigurisht, - ua ktheu luani. - E shikoni kapelën atje te muri? - tha duke treguar me gisht nga lumi. - Merreni dhe ma sillni këtu. Pastaj unë do të vendos se cili nga ju është më i miri.

Sapo e dëgjuan këtë, të dy kafshët u nisën me vrap. Krokodili që ishte mësuar në lumë, e kapërceu atë sa hap e mbyll sytë, dhe arriti pranë murit. Më pas priti të vinte elefanti. Ky i fundit zgjati hundën e tij të gjatë dhe e arriti kapelën me mjaft lehtësi.

Pastaj ata u kthyen sërish te lumi. Elefanti harroi që kapelën e kishte mbi kurriz dhe, ndërsa përpiqej të nxitonte, papritur rrëshqiti dhe kapela u fundos. Krokodili e pa se çfarë ndodhi, ndaj u zhyt menjëherë. E kapi kapelën me gojën e tij të madhe dhe, pasi doli nga lumi, e la atë në këmbët e luanit. Ky e mori kapelën dhe, duke iu drejtuar elefantit, tha:

- Ty të ndihmoi trupi dhe hunda jote për ta marrë kapelën nga muri, por më pas e humbe atë.
- Ndërsa ti, - iu kthye krokodilit, - megjithëse nuk mund ta arrijë kapelën, ishe në gjendje të zhyteshe dhe ta merrje atë.
- Të dy jeni të zgjuar sipas mënyrës suaj. Asnjëri nuk është më i mirë se tjetri, - u tha luani.

***Për pyetjet nga 1 deri në 5 qarkoni përgjigjen e saktë.***

1. Cila nga fjalët e mëposhtme ka kuptim të njëjtë me foljen *bisedonin*?

**1 pikë**

- A) Diskutonin
- B) Shprehnin
- C) Pajtoheshin
- D) Pyesnin

2. Lexoni me kujdes fjalinë: “*A mund të na tregosh se cila është kafsha më e mirë?* - thanë të dy njëherazi”.

Si reagoi luani ndaj kërkesës së elefantit dhe të krokodilit?

**1 pikë**

- A) Ai nuk pranoi t'u përgjigjej, duke i zhgënjyer kafshët.
- B) Ai propozoi një garë pa kuptim, duke shkaktuar një konflikt mes kafshëve.
- C) Ai tregoi interes për t'i ndihmuar kafshët që të zgjidhnin problemin e tyre.
- D) Ai iu drejtua kafshëve sikur të ishin të parëndësishme për të.

3. Cila nga fjalitë e mëposhtme tregon më së miri atë që ndodh mes elefantit dhe krokodilit në këtë ngjarje?

**1 pikë**

- A) Ata janë duke konkurruar me njëri-tjetrin.
- B) Ata kanë xhelozë për njëri-tjetrin.
- C) Ata janë mirënjohës ndaj njëri-tjetrit.
- D) Ata kanë dashamirësi kundrejt njëri-tjetrit.

4. Në këtë histori, luani më mirë mund të përshkruhet si: **1 pikë**
- A) argëtues,  
B) trim,  
C) i zgjuar,  
D) i këndshëm.
5. Ideja e kësaj historie është: **1 pikë**
- A) të gjithë kemi fuqi dhe aftësi të ndryshme.  
B) ne duhet të jemi të duruar me të tjerët.  
C) të gjithë kemi mundësi që t'i ndihmojmë të tjerët.  
D) gjithnjë duhet të përpiqemi që të bëjmë më të mirën.
6. Shkruani mendimin tuaj (duke e arsyetuar atë) nëse ju pëlqen apo jo mënyra se si veproi luani. **1 pikë**
- \_\_\_\_\_
7. Rishkruani fjalinë e dhënë duke e zgjeruar kryefjalën me fjalën *elefanti*. **1 pikë**  
*Krokodili arriti pranë murit.*
- \_\_\_\_\_
8. Qarkoni fjalinë dëftore. **1 pikë**
- A) Merreni dhe ma sillni këtu.  
B) Të dy kafshët u nisën me vrap.  
C) E shikoni kapelën atje tej?  
D) Shiko fuqinë time.
9. Gjeni përcaktorin e shprehur me mbiemër. **1 pikë**
- U zhyt menjëherë dhe e kapi kapelën me gojën e tij të madhe.* **Përcaktori:** \_\_\_\_\_
10. Ndërtoni një fjali me kundrinor të drejtë të shprehur me emër. **1 pikë**
- \_\_\_\_\_
11. Qarkoni ndajfoljen. **1 pikë**
- A) Mjaft,  
B) I mirë,  
C) E cila,  
D) Çfarë.
12. Përcaktoni kohën e foljes në fjalinë e mëposhtme. **1 pikë**
- Aty pranë kaloj një luan.* **Koha e foljes:** \_\_\_\_\_
13. Në cilën rasë është fjala e nënvizuar? **1 pikë**
- Ky e mori kapelën dhe iu drejtua elefantit.* **Rasa:** \_\_\_\_\_

### Riciklimi<sup>1</sup>

Shumë familje hedhin mesatarisht pesë kavanoza apo shishe në javë. Për fat të mirë, qelqi mund të riciklohet. Ju mund t’i hidhni shishet e përdorura në një kosh të veçantë të quajtur “depozita e shisheve”. Më pas kamionët i boshatisin këto depozita dhe i çojnë shishet e grumbulluara në një fabrikë qelqi. Atje pastrohen dhe copëtohen në copa shumë të vogla për të prodhuar shishe dhe kavanoza të rinj.

Çfarë mund të bëni?

Ju mund të blini shishe qelqi dhe jo plastike, pasi këto janë shumë më të lehta për t’u ricikluar. Nëse afër vendit ku banoni, ka një depozitë shishesh, i çoni atje shishet që keni përdorur. Bindni miqtë dhe të afërmit tuaj të bëjnë të njëjtën gjë.

Ndiqni rregullat e mëposhtme:

- Vendosini shishet ose kavanozat në depozitë.
- Vendosni në depozitë vetëm shishet dhe kavanozat. Materialet e tjera mund t’i dëmtojnë makineritë në fabrikë dhe ta ndotin qelqin.
- Mos lini kuti bosh apo çanta plastike afër depozitës së shisheve.
- Mos hidhni shishe në depozitë gjatë natës. Zhurma mund të shqetësojë njerëzit që banojnë aty pranë.

*Për pyetjet nga 14 deri në 16 qarkoni përgjigjen e saktë.*

**14.** Një depozitë shishesh është: **1 pikë**

- A) një shishe qelqi për të kursyer paratë.
- B) një kosh i veçantë për të grumbulluar shishet bosh.
- C) një kuti me shishe të radhitura sipas madhësisë.
- D) një dhomë e madhe ku grumbullohen shishe.

**15.** Cili është kuptimi i fjalës fabrikë? **1 pikë**

- A) Një vend ku fëmijët mësojnë të lexojnë.
- B) Një vend ku njerëzit jetojnë.
- C) Një vend ku prodhohen gjëra të ndryshme.
- D) Një vend ku njerëzit kalojnë kohën e lirë.

**16.** Cili është qëllimi kryesor i tekstit? **1 pikë**

- A) Të na mësojë një gjë të rëndësishme.
- B) Të na tregojë një histori interesante.
- C) Të na shpjegojë si të bëjmë diçka.
- D) Të na japë informacion rreth riciklimit.

**17.** Fjalitë e mëposhtme ju tregojnë se çfarë mund t’i ndodhë një shisheje qelqi, kur ajo është bosh. Fjalitë nuk janë renditur si duhet. Vendosni përbri tyre një numër që tregon se si duhen renditur ato. **1 pikë**

A. Shishja e qumështit ishte bosh.	
B. Kamioni erdhi të boshatisë depozitën e shisheve.	
C. Shishja u copëtua në pjesë të vogla.	
D. E çova shishen te depozita e shisheve.	
E. Xhami i ri u krijua nga shishet e thyera.	
F. Ata i çuan shishet në fabrikën e qelqit.	

<sup>1</sup> Riciklimi është procesi i ripërpunimit të mbeturinave.

## VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT FILLOR

18. Kujtoni një ngjarje kur keni ndihmuar dikë apo dikush ju ka ndihmuar (për shembull, ju ndihmuat një person të gjente diçka, ndihmuat dikë në kopsht apo ndihmuat dikë të mësonte).  
Shkruani një histori, duke treguar se çfarë ndodhi. Nëse nuk keni një histori të tillë, shkruani se si do të dëshironi të ndihmonit dikë apo dikush t'ju ndihmonte ju. **3 pikë**

Sigurohuni që në historinë tuaj të përfshini:

- vendin,
- njerëzit që janë në të,
- ngjarjen.

**Titulli:** \_\_\_\_\_

**Ku ndodh historia?**

---

---

---

**Kush merr pjesë në këtë histori?**

---

---

---

**Çfarë ndodh në këtë histori?**

**Ngjarja:**

---

---

---

---

---

**Përfundimi/Mbyllja:**

---

---

---

---

---

Matematikë

19. Renditni vlerat e mëposhtme, nga vlera më e madhe tek vlera më e vogël: 2 pikë

1; 0,1; 1,1; 1,01 \_\_\_\_\_

20. Nëse karrigia peshon 3.4 kilogram, masa e saj në **gram** është: 1 pikë


- A) 34
- B) 340
- C) 3400
- D) 34000

21. Rrethoni **V** nëse barazimi është i vërtetë dhe **G** nëse është i gabuar. 2 pikë

a)  $\frac{2}{3}$  e  $60 > 50$  V G

b)  $\frac{1}{4}$  e  $32 = 8$  V G

22. Gjeni masën e këndit që mungon dhe emërtoni llojin e trekëndëshit. 2 pikë



\_\_\_\_\_

23. Eralbi ha 6 racione me fruta në ditë. Vëllai i tij ha  $\frac{2}{3}$  e racioneve që ha Eralbi në ditë. Sa racione në ditë ha vëllai i tij? 2 pikë

24. Duke u nisur nga diagrami i mëposhtëm, gjeni sa është vlera e fytyrës së mërzitur. 1 pikë

+ = 13

x = 42


- = 1

= ?

= \_\_\_\_\_

25. Shprehni me thyesë pjesën e ngjyrosur dhe kryeni mbledhjen e thyesave.

3 pikë



$$\underline{\quad} + \underline{\quad} = \underline{\quad}$$


26.

a) Përcaktoni në rrjetin koordinativ pikat me koordinata:  
A (3; 10)    B (10; 10)    C (10; 4)    D (3; 4)

b) Bashkoni pikat e gjetura në rrjetin koordinativ, sipas radhës së mësipërme.

c) Çfarë figurë formohet nga bashkimi i pikave?

\_\_\_\_\_



2 pikë

1 pikë

1 pikë

27. Gjeni vlerën që mungon në shprehjen e mëposhtme.

2 pikë

$$(2 + 4) \cdot 5 = ? + 20$$



28. Emërtoni në dy njësi matëse.

1 pikë

$$5,7 \text{ cm} = \underline{\quad} \text{ cm } \underline{\quad} \text{ mm}$$

**Dituri Natyre**

29. Në figurat 1 dhe 2 jepen dy eklipse të ndryshëm. Përcaktoni në cilën prej figurave ka ndodhur eklipsi i Diellit. **1 pikë**




Eklipsi i Diellit ka ndodhur në figurën \_\_\_\_\_.

30. Djali në figurë, nëpërmjet një globi dhe një llambe, po kryen një eksperiment për të treguar, se si: **1 pikë**

- A) Hëna rrotullohet rreth Tokës;
- B) formohet dita dhe nata;
- C) Toka çliron nxehtësi;
- D) formohen stinët.




31. Plotësoni në figurë cili nga planetët e sistemit diellor është Toka. **1 pikë**



32. Në figurë jepet një enë më akull, një me ujë dhe një më avull. Që uji të kthehet në avuj uji, i duhet një temperaturë: **1 pikë**

- A) nën 0°C
- B) 40°C - 50°C
- C) 70°C - 90°C
- D) mbi 100°C



33. Figura tregon një tenxhere në flakë dhe një njeri, i cili po e mbulon atë me kapak. A është i drejtë veprimi që po bën ai? Shpjegoni pse. **1 pikë**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_



34. Figurat e mëposhtme tregojnë dy pamje: tufën e zogjve që cicërojnë dhe një gjenerator që prodhon energji elektrike. Tregoni një ndryshim midis cicërimeve të zogjve dhe asaj që dëgjohet nga gjeneratori. **1 pikë**

\_\_\_\_\_


\_\_\_\_\_





35. Pistili në figurën e mëposhtme përfaqësohet nga numri:

- A) 1
- B) 2
- C) 3
- D) 4



1 pikë

36. Nga grupi i fjalëve të mëposhtme zgjidhni fjalët e duhura për të plotësuar vendet bosh.  
(Jo të gjitha fjalët mund të përdoren.)

gojëza	klorofili	uji	dyoksidi i karbonit	oksigeni	nervura
--------	-----------	-----	---------------------	----------	---------

a) Bimët me anë të rrënjës thithin nga toka \_\_\_\_\_ dhe kripërat minerale.

1 pikë

b) Gypat përçues që marrin pjesë në ndërtimin e gjethes, quhen \_\_\_\_\_.

1 pikë

c) Gjatë procesit të fotosintezës bimët thithin nga mjedisi \_\_\_\_\_ dhe çlirojnë oksigjenin.

1 pikë

**MODELI II**

**VANAF**

Gjuhë shqipe

**Vajza dhe kali**

- Më trego edhe njëherë si mësove të kalërosh, - i thosha shpesh babait, kur isha e vogël. Nuk isha veçse katër vjeç, por më pëlqente të dëgjoja babanë teksa rrëfente historinë e tij.

- Kur isha i vogël, aq sa je ti tani,- fillonte ai, - më pëlqente të kalëroja, por isha shumë i vogël t'i hipja një kali. Kështu që më mbetej vetëm të shkoja në stallë për t'i parë kuajt dhe për t'i admiruar ata. Çfarë kafshësh të mëdha dhe të fuqishme që ishin! Kuajt qëndronin të qetë në vendet e tyre dhe hanin ushqim. Ngjitesha me shumë kujdes në kurrizin e kalit, pastaj shtrëngoja krifën (jelet) e tij dhe imagjinoja sikur vraponim të dy përmes lëndinës, përgjatë bregut, madje, edhe në det. Kur u rrita, dëshira ime u realizua.

- Tani ti noton me kuajt, - i thashë, - madje noton edhe me Maksin që është si shpirt. Të gjithë e njihnin Maksin, kalin e zi me krifën e mrekullueshme dhe të gjithë e dinin si sillej ai kur erdhi për herë të parë në stallë. Kali ngrihej fuqishëm mbi dy këmbët e pasme, shkroftinte dhe godiste me shkelma. Sytë i rrotulloheshin egërsisht. Të gjithë i trembeshin, me përjashtim të babait tim...

- Më trego si u bërë shok me Maksin, - i lutesha.

- Mirë vogëlushe, - vazhdonte im atë. - Në fillim vetëm i flisja. I flisja sikur ta kisha shok.

Edhe ti kështu duhet të veprosh. Duhet t'i thuash: - Jo, kalë i vogël, jo, miku im. Ti nuk mund të vraposh i lirë. Ti duhet të mësosh që të vrapojmë bashkë... Dhe shumë shpejt Maksi filloi të më dëgjonte. Ai e dinte nga zëri im se do të isha miku i tij.

Kështu Maksi e lejoi babanë që ta mësonte si të mbante në kurriz një kalorës. Më pas do ta merrte tim atë dhe të dy bashkë do të vraponin përmes lëndinave të gjelbra apo në ujërat e ndritshme të Detit të Veriut.

Më pëlqente shumë kur shikoja babanë që hynte në ujë bashkë me Maksin. Ata, notonin në ujë të ftohtë dhe të pastër. Shpesh i shikoja nga bregu, duke shtrënguar fort dorën e nënës. Babai dhe Maksi notonin kaq trimërisht. Isha shumë krenare për ta! Pastaj të dy dilnin nga uji, shkundeshin dhe ecnin me galop përgjatë bregut, në drejtimin tonë. Më pas bënin një ndalesë të bukur, tamam në kohë. Maksi tundte kokën, ngrihej madhërisht mbi dy këmbët e pasme, ndërsa pikat e ujit i shkëlqenin mbi gëzofin e zi. Babai qeshte dhe përkëdhelte qafën e Maksit. Në heshtje, mendoja vetëm një dëshirë: një ditë, edhe unë të kisha një kalë... por një kalë të vogël!

1. Si ishte Maksi kur erdhi për herë të parë në stallë?

**1 pikë**

- A) I qetë dhe dembel.
- B) I egër dhe plot gjallëri.
- C) Miqësor me të gjithë.
- D) I afruar vetëm me babanë e vogëlushes.

2. Ku i pëlqente më shumë vajzës që ta shikonte babanë e saj?

**1 pikë**

- A) Kur kalëronte në fermë.
- B) Kur shkonte në stallë te kuajt.
- C) Kur notonte në det bashkë me kalin.
- D) Kur vraponte në lëndinë bashkë me kalin.

3. Çfarë ndodh me vajzën, pasi shikon babanë duke kalëruar? **1 pikë**

- A) Ajo dëshiron një kalë tamam si Maksi.
- B) Ajo nuk shfaq ndonjë interes për kuajt.
- C) Ajo dëshiron të ketë një kalë të vogël.
- D) Ajo mendon se kuajt nuk duhet të shkojnë në det.

4. Çfarë mëson vajza nga historia e babait të saj? **1 pikë**

- A) Si të stërvitë një kalë.
- B) Si të notojë me një kalë.
- C) Si të bëhet shok me një kalë.
- D) Si të kalërojë një kalë pa shalë.

5. Në fjalinë “Kështu që më mbetej vetëm të shkoja në stallë për t’i parë kuajt dhe për t’i admiruar ata”, cili është kuptimi i fjalës *për t’i admiruar*? **1 pikë**

- A) për të vështruar dikë a diçka me kënaqësi;
- B) për të vështruar dikë a diçka me mall;
- C) për të vështruar dikë a diçka me frikë;
- D) për të vështruar dikë a diçka nxitimthi.

6. Gjeni në tekst dy fjalë ose shprehje që shprehin forcën e kalit të babait. **2 pikë**

\_\_\_\_\_

7. Vogëlushes i pëlqente të shikonte babanë kur notonte me kalin, por “shpesh i shikonte ata nga bregu, duke shtrënguar fort dorën e nënës.” Ç’tregon kjo? **1 pikë**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

8. Tregoni rasën e emrit të nënvizuar. **1 pikë**

*Shpesh i shikoja nga bregu.* **Rasa:** \_\_\_\_\_

9. Foljes *qëndroj* shtojini një emër me parafjalë. **1 pikë**

qëndroj (emër me parafjalë) \_\_\_\_\_

10. Përshtatni foljen me kryefjalën në fjalinë e mëposhtme. **1 pikë**

*Babai dhe Maksi **notoj** ( \_\_\_\_\_ ) fuqishëm në ujë.*

11. Tregoni kohën dhe vetën e foljes në fjalinë e mëposhtme. 2 pikë

*Pastaj të dy dilnin nga uji.*

**Koha:** \_\_\_\_\_

**Veta:** \_\_\_\_\_

12. Gjeni mbiemrin në fjalinë e dhënë më poshtë. 1 pikë

*Të dy bashkë do të vraponin përmes lëndinave apo në ujërat e ndritshme të Detit të Veriut.*

Mbiemri: \_\_\_\_\_

13. Grupin emëror *lëndinave të gjelbra* vendoseni në numrin njëjës, pa ndryshuar rasën. 1 pikë

\_\_\_\_\_

14. Zgjeroni fjalinë duke i shtuar një përcaktor fjalës *miku*. Tregoni me se është shprehur përcaktori

që shtuat.

**2 pikë**

*Ai e dinte nga zëri im se do të isha miku i tij.*

\_\_\_\_\_

Shprehur me:

\_\_\_\_\_

15. Qarkoni fjalinë dëftore. 1 pikë

- A) Edhe ti kështu duhet të veprosh.
- B) Më trego si u bërë shok me Maksin.
- C) Unë ngjitesha me shumë kujdes në kurrizin e kalit.
- D) Çfarë kafshësh të mëdha dhe të fuqishme që ishin!

## Mos përdor makinë!

Ke nevojë të shkosh diku? Për të bërë pazar... në shtëpinë e një miku.... në kinema? Rruga më e lehtë është që të shkosh me makinë. Por kjo nuk është e mirë për Tokën. Makinat shkaktojnë ndotje, prandaj sa më pak t'i përdorim, aq më pak ndotje do të ketë në planetin tonë. Sigurisht, juve do t'ju duhet pak kohë për të shkuar atje ku dëshironi... Por a nuk na kërkon shumë përpjekje edhe dëshira për të pasur ajër dhe ujë të pastër?

### A e dini?

Ka me miliona makina dhe kamionë sot në mbarë botën. Çdo vit ato udhëtojnë me miliona e miliona kilometra.

Kur makinat djegin karburantin, ato prodhojnë gazra helmues, të cilat janë të dëmshme për Tokën, pasi përmbajnë grimca të padukshme që shkaktojnë shiun acid<sup>2</sup>.

Biçikletat nuk çlirojnë gazra të dëmshme, ato nuk ndotin. Nëse përdorni biçikletën, ju i bëni një shërbim të madh Tokës, e shpëtoni atë.

Në disa vende, shumë njerëz përdorin biçikletat në vend të makinave.

### Çfarë mund të bëni?

Herën tjetër, kur të shkoni diku, mendoni dy herë përpara se të kërkonti t'ju çojnë me makinë: a mund të shkoni në këmbë apo me biçikletë?

16. Në një udhëtim të shkurtër është më lehtë:

1 pikë

- A) të ecësh.
- B) të shkosh me makinë.
- C) të shkosh me biçikletë.
- D) të marrësh autobusin.

17. Makinat:

1 pikë

- A) e ndotin më shumë Tokën.
- B) e ndotin më pak Tokën.
- C) janë të mira për ju.
- D) nuk kanë ndikim në planet.

---

<sup>2</sup> Shiun acid është një lloj shiu që ka një nivel të pazakontë aciditeti. Ai shkakton efekte të dëmshme mbi bimët, kafshët ujore etj.

18. Biçikletat janë më të mira se makinat, sepse:

1 pikë

- A) e pastrojnë ajrin.
- B) ecin edhe në ujë.
- C) e ndërpresin pastrimin e ajrit.
- D) nuk e ndotin ajrin.

19. Ku mund të lexohet një pjesë e tillë?

1 pikë

- A) Në një libër që flet për biçikletat.
- B) Në një libër që flet për mjedisin.
- C) Në një libër që flet për makinat.
- D) Në një libër që flet për kopshtarinë.

20. Pasi të lexoni pjesën, si do t'i përgjigjeshit pyetjes "A mund të shkoni në këmbë apo me biçikletë?". Shkruani dy arsye.

2 pikë

- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_

21. Plotësoni përmbledhjen e mëposhtme duke vendosur fjalën ose fjalët e duhura në vendin bosh.

Ju nuk keni nevojë t'i përdorni të gjitha fjalët.

3 pikë

biçikletë	eci	karburant	
përdor	ndotje		shiu acid
mendoj	udhëtim	ajër i pastër	

Kur kemi nevojë të shkojmë diku, shpesh \_\_\_\_\_ një makinë. Ne nuk mendojmë për distancën apo \_\_\_\_\_ e shkaktuar nga djegia e \_\_\_\_\_.

Ne duhet \_\_\_\_\_ përpara se të shkojmë diku. Ndoshta duhet \_\_\_\_\_ ose \_\_\_\_\_ në vend që të shkojmë me makinë.

**22. Të shkruajmë**

**3 pikë**

Një djalë i vogël gjeti në breg të detit një shishe dhe brenda saj një letër. Në të shkruhej:

*161 Vesti Vei  
Norvegji  
26 janar 2010*

*I dashur mik,*

*Më quajnë Jan dhe jetoj në Norvegji. Jam 11 vjeç dhe sapo kam mbaruar klasën e pestë.  
Po e nis këtë letër në shishe, për të parë se sa larg mund të shkojë. Nëse e gjen, do të më pëlqente të më shkruaje.*

*Faleminderit,  
Jan Klosse*

Shkruajini një letër Janit.  
Sigurohuni që në historinë tuaj të përfshini:

Ku dhe si e gjetët letrën?	Ku jetoni?
<hr/> <hr/>	<hr/> <hr/>

Familja ime dhe unë	Interesat dhe dëshirat e mia
<hr/> <hr/> <hr/>	<hr/> <hr/> <hr/>

**Letra**

---



---



---



---



---



---



---



---



---



---



**Matematikë**

23. Jepen dy numërorë: 2570 dhe 439. Gjeni ndryshesën e tyre. 1 pikë

24. Shkruani numërorin 210 500 me fjalë. 1 pikë

\_\_\_\_\_

25. Thyesa që e ka vlerën 1 është: 1 pikë


A)  $\frac{3}{10}$

B)  $\frac{7}{7}$


C)  $\frac{23}{5}$

D)  $\frac{5}{23}$

26. Vendosni në boshtin numerik numrat: -3, -1, 3. 1 pikë



27. Emërtoni trupin gjeometrik: 1 pikë



\_\_\_\_\_

28. Plotësoni vargun: 1 pikë


2, 5, 8, 11, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_

29. Gjeni vlerën e ndryshores  $x$  nga bashkësia {39, 50, 75, } të tillë që: 1 pikë

$x - 10 > 41$

30. Shkruani thyesën që tregon pjesën e vijëzuar.

1 pikë



31. Shuma e këndeve të një trekëndëshi është:

1 pikë

- A)  $90^\circ$
- B)  $150^\circ$
- C)  $180^\circ$
- D)  $360^\circ$

32. Gjeni vlerën e shprehjes numerike:

2 pikë

